

**Fjalori historik i arabishtes i Dohas -
kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore**

Isa Memishi*

Abstrakt

Leksikografia ndër arabët ka një traditë mjaft të hershme dhe të bujshme. Edhe pse fjalori i parë i arabishtes ishte hartuar që në shekullin e VIII nga Ḥalīl Bin Ahmād Bin âl-Fârāhīdij, u desh të pritët shekulli XXI që të kemi fjalorin historik të arabishtes.

Ide për hartimin e një fjalori historik të gjuhës arabe kishte edhe më herët. Ndër iniciativat më serioze për hartimin e një fjalori të këtyre përmasave është ai i Akademisë së Gjuhës Arabe në Kajro, në vitin 1932. Një nismë tjetër për hartimin e fjalorit historik të arabishtes ka qenë ajo e orientalistit gjerman August Fischer në vitin 1913. Pas kësaj kemi nismën e Abdulla âl-‘Alājlī në Liban. Një projekt tjetër për hartimin e fjalorit historik të gjuhës arabe ka qenë edhe projekti i Asocionit të Akademisë së Gjuhës Arabe dhe Shekncave në Tunizi.

Gjithë këto përpjekje nuk u jetësuan, nuk rezultuan me ndonjë sukses konkret për të pasur Fjalorin historik të gjuhës arabe të plotë. Nga Fjalori i Fischerit, dritën e botimit e pa vetëm vëllimi iparë, i botuar më 1967 në Kajro dhe ai i Abdulla âl-‘Alājlīt me vetëm një vëllim të botuar më 1963.

Projektin e shumëpritur për Fjalorin historik të arabishtes, më 25 maj 2013 e lansoi Qendra Arabe për Kërkime në Doha me një ekip në krye me Râmzi Ba‘lâbâkun, kurse përfundimin e etapës së parë, nga tri gjithsej, e promovoi në dhjetor të vitit 2018.

Fjalët kyeçe. Fjalori historik i arabishtes, Doha, Fischeri, Akademia e Gjuhës Arabe.

* Profesor i gjuhës arabe në Degën e Orientalistikës në F. Filologjik të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë, autor i *Fjalorit arabisht-shqip* (2011).

Hyrje

Fjalorët historikë dallojnë nga fjalorët e zakonshëm. Derisa këta të fundit japin sqarime rreth kuptimit të një fjale të caktuar, pa u ndalur në historikun e asaj fjale dhe në evoluimin e kuptimit të saj, fjalorët historikë ofrojnë të dhëna se kur për herë të parë është përdorur një fjalë e caktuar, kuptimi i parë i saj dhe transformimi semantik dhe strukturor. Fjalorët historikë regjistrojnë gjithë trashëgiminë leksikore të teksteve, qofshin ato të gdhendura apo të regjistruara në tekstet e vjetra. Pikërisht kjo është vlera e këtyre fjalorëve. Fjalorët historikë prezantojnë leksikun me mjete racionale.

Një çështje që është diskutuar ndër leksikografët arabë është ajo se cila është gjuha letrare arabe dhe, në kuadër të saj, cili duhet të jetë leksiku që duhet të prezantohet në fjalorët historikë?

Sipas August Fischerit, atëbotë edhe arabologët më të njohur ende nuk ishin të një mendjeje se cila arabishte ishte për ta arabishtja letrare.¹ Sipas pjesës dërmuese të historianëve të gjuhës arabe, arabishte letrare konsiderohej i gjithë leksiku që mund të dëshmohej, duke e ndarë në tri fusha:

1. Leksiku i Kuranit, duke e besuar si fjalë të Perendisë së lartëmadhërisë;
2. Leksikun e hadithit, duke e besuar fjalë të Profetit Muhamed;
3. Leksiku i klasikëve arabë. Në këtë fushë është përfshirë i gjithë leksiku i veprave të sistemuara apo të pasistemuara nga klasikët.

Në grupin e klasikëve janë përfshirë tri gjenerata.

¹ أ. فيشر، المعجم اللغوي التاريخي، القاهرة، ١٩٧٦، ص ٧.

1. Gjenerata e parë është gjenerata e poetëve të periudhës paraislame, si si'Imru'u-l-Ķajs e të tjerë;
2. Gjenerata e poetëve që kanë jetuar në periudhën paraislame dhe në atë islame;
3. Gjenerata e poetëve të quajtur poetë islamë, që nuk kanë jetuar në periudhën paraislame.
4. Gjenerata e poetëve pas klasikëve e deri në ditët tona, ndryshe këta poetë quhen edhe poetë bashkëkohorë. Në këtë gjeneratë përfshihen poetët duke filluar nga Bâshâr Bin Burd, Ebu Nuvâs e të tjerë.

Fischer e përkrah mendimin e Abu Naşr âl-Fârâbî (874-950), të shfaqur në hyrje të veprës së tij *Kitābu-l-hurūf*, ku thotë: Kurejshitët janë arabët më të qartë në theks, janë arabët që më së lehti shqiptojnë arabishten, gjuha e tyre është më e bukura për veshin, duke vazhduar se, nga ky fis janë edhe autorët klasikë si'Imru'u-l-Ķajsi, Tâmilmi dhe të tjerët.² Fischer, duke vlerësuar pjesën më të madhe të leksikut të gjuhës së poezisë klasike, shkon edhe më larg duke e quajtur atë varietet edhe *Lingua franca poetica*.

Për të dhënë një pasqyrë rreth zhvillimit të hartimit të fjalorit historik të arabishtes, së pari duhet parë zhvillimin e leksikografisë arabe.

Sipas historianëve të historisë së gjuhës arabe, shkollat më të rëndësishme të leksikografisë arabe janë katër:³

² أ. فيشر، المرجع السابق، ص ١٢.

³ دكتور عبد الحميد محمد أوسكين، المعاجم العربية مدارسها ومناهجها، جامعة الأزهر، ١٩٨١، الطبعة الثانية ص ٢٦-٢٨.

Shkolla e parë e leksikografisë arabe

Fjalor i parë i gjuhës arabe konsiderohet "*Kitābu-l-ʿAjn*", me autor Ḥalīl Bin Ahmed Bin âl-Fârāhīdij (718-786). âl-Ḥalīl Bin ʿAhmed konsiderohet pionier në fushën e leksikografisë arabe dhe njihet si themelues i shkollës së parë në leksikografinë arabe. âl-Ḥalīl, sipas Fisherit, për shekuj me radhë është konsideruar ndër filologët më të njohur në historinë e arabistikës. Ai gjithashtu konsiderohet edhe themelues i metrikës arabe dhe i arabistikës.⁴

Ajo që e bën karakteristik fjalorin e tij nga fjalorët e traditës arabe, është sistemi i renditjes së fjalëve. Renditja alfabetike e këtij fjalori është bërë sipas vendshqiptimit të konsonanteve të alfabetit arab, një traditë e renditjes së alfabetit të sanskritishtes. Ai renditjen e fjalëve në fjalor e fillon me konsonantet grykore, e pastaj me ato qiellëzore, për të vazhduar me dentalet dhe më në fund me konsonantet buzore.

Ky sistem i renditjes alfabetike njihet njëherësh edhe si shkolla e parë në leksikografinë arabe. Këtë sistem e ndoqën edhe disa autorë të tjerë pas âl-Ḥalīl Bin ʿAhmedit, siç janë: Âbu ʿAlī al-Ḳālī (901 - 967) me veprën *âl-Bārī ʿu*;⁵ Âbu Mânşūr âl-ʿÂz'hârij (895-981) me veprën *Tâhdhību-l-luga*;⁶ Âbu Bâqr Bin âl-Ḥasan âz-Zubâjdī âl'Ishbīlī (vdiq më 989) me veprën *Muḥṭâṣâru-l-ʿajni*; Şāhib Bin ʿIbāde (935-985) me fjalorin e tij *âl-Muḥīṭ fī-l-luga*⁷ dhe Ibn Sâjjid (1007-1066) me fjalorin *âl-Muxhem vâ-l-muḥīṭul-l-ʿa ʿzam*.

⁴ أ. فيشر، المرجع السابق، ص ٤.

⁵ لمزيد من التفاصيل: دكتور حسين نصار، المعجم العربي نشأته وتطوره، الجزء الأول، دار المصير للطباعة، ١٩٨٨، ص ١٤٥.

⁶ الجوهري، الصحاح، الجزء ١، تحقيق أحمد عبد الغفور العطار، الطبعة الرابعة ١٩٨٧، دار العلم للملايين، لبنان، ص ٨.

⁷ دكتور حسين نصار، المرجع السابق، ص ٣٣٢.

Shkolla e dytë e leksikografisë arabe

Themelues i shkollës së dytë të leksikografisë arabe njihet Ibn Durâjdi (837-933) me vepërën e tij *Xhâmhârâ*. Ky autor ndjek sistemin e renditjes së fjalëve sipas një parimi krejt tjetër nga shkolla e parë e leksikografisë arabe. Sa për ilustrim, po përmendim fjalën عجم /'axhâmâ/ të cilën e rendit tek konsonanti ج/xh/ duke u bazuar në parimin se konsonanti ج/xh/, sipas renditjes alfabetike, nga tri konsonantet bazike, është konsonanti i parë në alfabetin arab.⁸

Shkolla e tretë e leksikografisë arabe

Shkolla e tretë e leksikologjisë arabe konsiderohet shkolla e ashtuquajtur *Shkolla kafije*. Themelues i kësaj shkolle konsiderohet âl-Fârâbî, me vepërën e tij *Divānu-l-âdâb*. Për dallim nga dy shkollat e para, ky autor ndjek një metodë të veçantë në renditjen fjalëve në fjalor. âl-Fârâbî fjalorin e tij e ndan në kapituj. Renditjen e kapitujve e bën sipas renditjes alfabetike tradicionale në leksikologji, por që fjalët i rendit duke marrë konsonantin e fundit të asaj fjale. Fjalën بحث /bâḥathâ/ e rendit te kapitulli i konsonantit ث/th/. Ky sistem i kërkimit të fjalëve në fjalor konsiderohet ndër më të zorshmit.

Këtë shkollë të leksikografisë e ndoqën âl-Xhâvhârî (vdiq më 1003) me vepërën e tij *aṣ-suḥāḥā*. Kësaj shkolle i përkasin Ibn Mânẓūr (1232-1311) me vepërën e tij *Lisāni-l-ʿarab*; Fâjrūz ʿĀbādī (1328-1414) me vepërën *âl-Kāmusu-l-muḥīṭ* dhe âz-Zubâjdī (1732-1790) me vepërën *Tāxhul-l-ʿarūs*.

⁸ د. علي محمود الصراف، أصول المعجم العربي، المجلة الأردنية في اللغة العربية وآدابها، المجلد (٩)، العدد (٤)، ٢٠١٤، ص ١٨٣.

Shkolla e katërt e leksikografisë arabe

Themelues i kësaj shkolle të leksikografisë konsiderohet Âbu ‘Amru -sh-Shâjbânî (728- 821) me veprën e tij *âl-Xhīm*. Renditja e fjalëve në fjalor, sipas këtij sistemi, është renditje alfabetike.

Fjalët, pasi të jenë liruar nga ndajshesat, renditen sipas rendit alfabetik.

Ky sistem i renditjes së fjalëve në fjalor është ndër më të thjeshtit dhe më lehtë i përdorshëm. Meqenëse është sistemi më praktik, prandaj edhe ka gjetur shtrirje kohore dhe deri diku është sistem standard në hartimin e fjalorëve edhe në ditët tona.

Ndjekësit më të njohur të kësaj shkolle të leksikografisë arabe janë: Ibn Fâris (941-1005) me veprën e tij *Mâkājīsu-l-luga*,⁹ âl-Zâmaḥashârî (1074-1143) me veprën e tij *’Âsâsu-l-bâlāga*, âr-Rrazî (vdiq më 1261) me veprën e tij *Muḥtâru ’ṣ-siḥāh*, dhe fjalorët bashkëkohor si *âl-Mu ḫhâmu-l-vâṣīṭ*, *âl-Mu ḫhemu-l-vexhīz*, *âl-Mu ḫhemu-l-kâbīr* etj.

Pavarësisht faktit se leksikografia arabe kishte një të kaluar mjaft të begatshme dhe, pavarësisht asaj që u cek më lart lidhur me shkollat e leksikografisë arabe, nuk shohim ndonjë iniciativë apo përpjekje për hartimin e një fjalori historik të arabishtes. Karshi gjithë kësaj trashëgimie në leksikografi dhe veprave nga fusha e gjuhësisë, si *’Âlfijâtubnu-l-Mālik* dhe *âl-Âxhrūmiyâ*, me autor Ibnu ’Âxhrūm, asnjë autor nuk prezantoi tekste nga gjuha klasike arabe, por gati të gjithë autorët i referoheshin njëri-tjetrit dhe citoreshin mes veti. Arabishtja kishte nevojë për një fjalor

⁹ د. علي محمود الصراف، المرجع السابق، ص ١٨٦.

historik, ku do të pasqyrohej historia e leksikut të gjuhës arabe dhe ku do të regjistrohej e gjithë ajo trashëgimi leksikore.

Iniciativa e parë për hartimin e një fjalori historik të gjuhës arabe ishte nga Akademia e Gjuhës Arabe në Kajro në vitin 1932.

Pas kësaj kemi iniciativën e Abdulla âl-‘Alājli (1914-1996) në Liban, i cili e hartoi Fjalorin historik të arabishtes të titulluar *al-Marxhi* me 1963.

Një projekt tjetër për hartimin e fjalorit historik të gjuhës arabe ka qenë edhe ai në Tunizi, nga Asocioni i Akademisë së Gjuhës Arabe dhe Shkencave.

Një ndër iniciativat më serioze për hartimin e *Fjalorit historik të arabishtes* ka qenë ajo e orientalistit August Fischer, në vitin 1913.

Me këtë rast, shkurtimisht do të ndalemi për të parë historinë e inisiativës së August Fischerit për hartimin e fjalorit historik të arabishtes dhe projektin e Abdulla âl-‘Alājlit. Përkundër faktit që këta dy autorë i kishin realizuar projektet e tyre, njëri në tërësi e tjetri gati të plotë, megjithatë dritën e botimit e panë vetëm me nga një vëllim.

August Fischeri (1865-1949), orientalist gjerman i specializuar në arabistikë në fushën e morfologjisë, sintaksës dhe leksikologjisë, ishte pasues i rrugës së profesorit të tij, filologut të madh Heinrich Leberecht Fleicher,¹⁰ i cili është edhe themelues i shkollës së njohur në orientalistikën gjermane me emrin *Shkolla e Leipsiger*. Ai ndoqi metodën që studimet të

¹⁰ Heinrich Leberecht Fleicher (1801-1888) është ndër studiuesit më të njohur të studimeve orientale në shekullin nëntëmbëdhjetë. Në arabisht ka botuar veprën *"Tarīḥ ābī āl-Fedā"*, të njëjtën vepër e ka përkthyer edhe në gjermanisht. Ai gjithashtu ka hartuar edhe një katalog të quajtur *"Katalog i dorëshkrimeve orientale të ruajtura në Drezden"*. Me 1845 themeloi *"Shoqatën orientale-gjermane"*.

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore mbështeten në dokumente dhe në prova të arabologëve, në rend të parë, dhe në rezultatet e filologëve arabë, duke qëndruar larg supozimeve të cilat mund të jenë mahnitëse, por të pabazuara.¹¹

A. Fischer është autoritet i pakontestueshëm në studimet e gjuhëve orientale, si në arabisht, në hebraisht, në persisht, në sirianishte dhe në gjuhët e tjera.¹² Fischer ishte njohës i mirë letërsisë arabe dhe i historisë së kulturës. Ai ishte i apasionuar pas gjuhës arabe, posaçërisht pas leksikologjisë arabe. Duke u marrë me letërsinë arabe, me leximin e teksteve nga letërsia arabe, ai u thellua në leksikun e gjuhës arabe. Gjatë gjithë jetës së tij akademike, ai u përkushtua në etimologjinë e leksikut të gjuhës arabe.

A. Fischer, duke shprehur admirim për të gjithë autorët e fjalorëve të gjeneratave para tij, thotë se të gjithë autorët kishin ndjekur njëri-tjetrin dhe se tani ishte koha që të shihej se cilat ishin mangësitë e atyre fjalorëve dhe të shihej në mos ishte koha për një fjalor të ri dhe më të pasur. Fischer, pas botimit të fjalorit të Oxford (OED), fjalor i parë historik i plotë, prezantoi idenë e tij për hartimin e fjalorit historik të arabishtes.¹³

Që në fazën fillestare Fischeri shtron pyetjen se si do të dukej një fjalor i gjuhës arabe letrare i përshtatshëm për zhvillimin e arabistikës në shekullin XX? Ai, në projekt-propozimin e tij për hartimin e fjalorit historik të arabishtes, thotë: ky fjalor duhet të përfshijë gjithë leksikun e gjuhës

¹¹Për më shumë rreth jetës dhe veprës së Fischerit, shih Abdurrahman Bâdâvî, Leksikon i Orientalistëve, Logos A, Shkup, 2015, f. 31-35.

¹²مصطفى يوسف، المستعربون في خدمة العربية،

<http://www.m-a-arabia.com/vb/showthread.php?t=11416>

¹³د. علي توفيق الحمد، المعجم التاريخي العربية (مفهومه، وظيفته، محتواه)، المجلة المعجمية، ع ٥، ١٩٩٠، تونس، ص 100.

<http://mohamedrabee.net/library/pdf/c310f20a-420d-4e93-9211-1cd8f721538c.pdf>

arabe që ka gjetur, pa përjashtime, duke pasur parasysh këto kritere: kriterin historik, etimologjik, polisemik, sintaksor dhe frazeologjik. Fischeri gjithë këto kritere i shtjellon më tej në parathënien e fjalorit të tij, për të cilin do të bëjmë fjalë në vijim.

Fischeri, në raportin që e kishte prezantuar para Akademisë së Gjuhës Arabe në Kajro në vitin 1936, kishte prezantuar parimet kryesore të Fjalorit historik të arabishtes. Ai kishte prezantuar pesë parime të cilave do t'u përmbahej:

1. Struktura e përmbajtjes së fjalorit. Aty do të prezantohej burimi nga është vjelur secila fjalë;
2. Mënyra se si është vjelur materiali. Për secilën fjalë kishte skedë të veçantë, duke prezantuar strukturën dhe kuptimin e saj.
3. Strukturën e fjalorit. Në këtë pjesë kishte prezantuar renditjen e fjalëve, duke filluar nga konsonanti i parë, i dytë, i tretë, e kështu me radhë, dhe për secilën fjalë trekonsonantike duke e prezantuar atë me të gjitha derivatet e saj.
4. Rregullat kryesore të leksikografisë. Vokalizimin e secilës fjalë, verifikimin, strukturën, kuptimin, duke e argumentuar me argumente të dokumentuara përgjatë historisë së përdorimit të asaj fjale.
5. Përkthimin e përmbajtjes së çdo fjale në njëërën nga gjuhët evropiane, në gjuhën angleze apo franceze.

Fischeri ia kishte dalë të regjistronte trashëgiminë gjuhësore nga shkrimet e para e deri në vitin 300 hixhri (fillon më 18.08.912). Ai ndjeu mungesën e një fjalori të arabishtes të këtyre përmasave, për të përkthyer ilustrimet e cituara nga poezitë nëpër literaturë, sidomos pjesë të shkëputura nga poezia paraislame, e duke u përqendruar në poezinë e

—— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore periudhës emevite.

Këtë projekt Fischeri për herë të parë e bëri publik në vitin 1907, gjatë mbajtjes së Kongresit të Filologëve Gjermanë në Bazel. Projektin e tij e përsëriti edhe në Konferencën ndërkombëtare të orientalistëve, e cila u mbajt në Kopenhagen, në vitin 1908. Fischeri edhe në konferencën tjetër në Athinë, në vitin 1912, e prezantoi po të njëjtin projekt.¹⁴ Në diskutimet nëpër seancat e këtyre konferencave ai bëri me dije se karakteristikë e këtij fjalori do të ishte gjuha klasike arabe. Aty do të përfshihej gjuha e poezisë së periudhës paraislame e deri në fund të periudhës emevite, gjuha e Kuranit, gjuha e hadithit dhe gjuha e historianëve më të vjetër. Ai pohonte se do të shfrytëzonte edhe materiale leksikore të cilat i kanë lënë arabologët evropianë para tij, në rend të parë Heinrich Leberecht Fleischer dhe Heinrich Thorbecke.

Komisioni kompetent i formuar në Kopenhagen u pajtua me konstatimin në vijim: Komisioni përshëndet nismën e Kongresit të pesëmbëdhjetë të orientalistëve që të përkrahë projektin e Fischerit për hartimin e fjalorit të gjuhës arabe letrare në harmoni me frymën e hartimit të fjalorëve bashkëkohorë. Unanimisht miratojmë këtë iniciativë dhe shpresojmë që të sigurohen mjete dhe materiale për realizimin e këtij projekti.¹⁵

Fischeri, projektin rreth hartimit të këtij fjalori e filloi në vitin 1914, me themelimin e Institutit për Hulumtime Saksofone në Leipzig, ku Fischeri zgjedhet drejtor i sektorit të arabistikës–islamistikës.

Fischeri, në vitin 1918, duke u bazuar në kapacitetet e tij, kishte

¹⁴ الأستاذ الدكتور محمد رشاد الحمزاوي، مجلة معجمية، توني، ع. ٦-٥، ١٩٩٠، ص ١٥.

¹⁵ أ. فيشر، المرجع السابق، ص ٣٠.

menduar që këtë projekt ta përfundonte brenda tri - katër viteve, por kriza financiare që e kishte kapluar atëbotë Gjermaninë, kishte ndikuar edhe në krizën financiare të Institutit të Lajpcingut, andaj atij iu desh që projektin e tij ta vazhdonte pa ndihmën e bashkëpunorëve.

Në vitin 1936 projekti i Fischerit kishte marrë rrugë për rrumbullakësimin e tij. Në vjeshtën e atij viti Qeveria e Egjiptit, me propozimin e Akademisë së Gjuhës Arabe në Kajro, mori përsipër shpenzimet për botimin e Fjalorit historik të arabishtes dhe në të njëjtën kohë të mbulojë shpenzimet për qëndrimin e Fischerit në Kajro gjatë stinës së dimrit, me të vetmin qëllim që të përfundohej ai projekt. Kjo përkrahje nga qeveria e Egjiptit i mundësoi Fischerit që të sigurojë një numër të konsiderueshëm të bashkëpunorëve egjiptianë dhe të sigurojë mjete për blerjen e veprave të cilat i nevojiteshin.

Tani, në këto rrethana të reja të krijuara në Kajro, Fischeri thotë se i duhen rreth shtatë vjet për ta përfunduar projektin e tij. Ai ishte i vetëdijshëm për sfidat, ndaj thotë se Muḥamād Murteḏā âl-Ḥusejn âz-Zubejdīt i janë dashur katërmbdhjetë vjet për ta përfunduar fjalorin e tij *Tāxhu-l-‘arūs min-xhâvḥâri-l-kāmūs*, edhe pse pjesën më të madhe të materialit e kishte vjelë nga fjalori *Lisānu-l-‘arab*, kurse kolegut të tij Eëdëard Lanes i ishin dashur pesëdhjetë e një vjet punë për ta përfunduar fjalorin e tij. Fischeri në vazhdim përmend një varg autorësh që me decenie të tëra kishin punuar deri në botimin e fjalorëve të gjuhës arabe në gjuhën frenge dhe angleze. Ai më në fund përmend përvojen e hartimit të Fjalorit Oxford English Dictionari, ku thotë se hartimi i tij ka filluar në vitin 1884 dhe ka përfunduar në vitin 1924, duke u angazhuar në atë punë qindra ekspertë.

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore

Fischeri, në fajlorin historik të arabishtes, siç thotë edhe vetë, kishte vendosur të fillonte me mbishkrimet e gdhendura, që ishin zbuluar asokohe, e që i takonin shekullit të VI, dorëshkrimet në papiruse dhe në monedha, duke përfunduar me materialin e vjelur deri në fund të Kalifatit Omajad (v.750).

Lidhur me idenë e Fischerit për hartimin e Fjalorit historik të arabishtes ka mendime të ndryshme. Dr. 'Ibrahīm Mâdkūr, atëbotë sekretar i përgjithshëm i Këshillit për botimin e këtij fjalori, mendon se për ta marrë këtë nismë Fischeri ishte frymëzuar nga Fjalori i Oxfordit. Por, Prof. Dr. Muhammâd Râshshâd âl-Hamzâvī mendon se orientalisti Heinrich Thorbecke¹⁶ dhe orientalisti F. Heerdegen ishin ata që e frymëzuan Fischerin për të hartuar Fjalorin historik të arabishtes.¹⁷

Karshi kontributeve të Heinrich Leberecht Fleicherit dhe Heinrich Thorbeckes, Fischeri kishte ndërmend të përdorte edhe fjalorë që kishin botuar apo kishin lënë në dorëshkrim orientalistët, si: Dozi, Fleicher, Thorbecke, Alfedi dhe Goldziher. August Fischer punën në këtë projekt e pati filluar në vitin 1913, duke vendosur skedat me ilustrimet e shkëputura nga fjalorët dhe nga divanet.

Në këtë projekt Fischerit i kishin ndihmuar edhe Johs Pedersen, John Leëis Enoch, me prejardhje egjiptiane nga Mânfâluti, Munīr Hamândij, egjiptian nga Kajro dhe Emalia Ėodenberg. Në këtë projekt gjithashtu kanë marrë pjesë edhe Arthur Schaade dhe Erich Braunlich. Për përfundimin e këtij projekti madhor, në vitin 1932 në Egjipt u formua Asambleja e

¹⁶ Për më shumë për Heinrich Thorbecke shih, Abdurrahman Bâdâvi, op.cit. f. 153-154.

¹⁷ عبد العزيز بن حميد بن محمد الحميد، المعجم التاريخي لدى المستشرق الألماني أوجست فيشر، شبكة صوت العربية، <http://www.voiceofarabic.net/ar/articles/2355>.

arabologëve, kurse Fischeri u zgjodh anëtar i këtij komisioni. Komisioni filloi punën me grumbullimin e materialit për këtë fjalor. Fischeri për çdo dimër frekuentonte Kajron. Kjo zgjati deri në vitin 1939. Atë vit kur shpërtheu Lufta e Dytë Botërore, Fischeri nuk pati mundësi të kthehej në Egjipt, posaçërisht pasi që në vitin 1945 u anulua anëtarësimi i tij në komisionin e themeluar në vitin 1932.

A thua cili ka qenë fati i materialit të grumbulluar që iu besua Asamblesë së arabologëve? Asamblesë, gjatë transferimit nga objekti i saj në rrugën *Kaşru-l-‘ajn* për në rrugën *Mârād* në *al-Gîzâ*, iu shkapërderdh i tërë materiali i grumbulluar i fjalorit. Nga i gjithë ai material mbeti vetëm një pjesë e vogël. Universiteti i Tubingenit dhe disa universitete të tjera gjermane u përpoqën që t’i kopjojnë ato materiale, më të vetem dëshirë që të vazhdonin punën në këtë projekt të fjalorit, për të cilin Fischeri pati punuar gjatë kohë. Mirëpo puna mbeti aty ku kishte filluar. Përkundër apeleve të shumta, askush nuk punoi për ta vazhduar këtë projekt. Kështu humbi pjesa më e madhe e materialeve që i pati grumbulluar Fischeri me ndihmësit e tij.

Në vitin 1957 u botua vëllimi i parë dhe i vetëm nga i gjithë ai material. Fjalori u titullua *âl-Mu ḫâmu-l-lâgâviyy ât-târiḥijj*.¹⁸ Në këtë vëllim është përfshirë parathënia e fjalorit me 34 faqe dhe 53 faqe material të fjalëve të para që fillojnë me konsonantin e parë *hânzâ^{në}* e deri te folja *âbâdâ*.

Fjalori i Fischerit konsiderohet ndër fjalorët më të mirë të hartuar nga ana e orientalistëve që kanë kontribuar në leksikografinë arabe. Dr. Ibrahim Medkûr për fjalorin e Fischerit thotë se është hartuar me të njëjtën

¹⁸ Sipas disa burimeve, ky fjalor është emërtuar *âl-Mu ḫâmu ât-târiḥijj*.

—— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore metodologji sikurse *Fjalori historik i Oksofrdit*.

Se sa gjithëpërfshirës ka qenë projekti i Fischerit shihet nga paraqitja e tij në një mbledhje të grupit punues, ku kishte deklaruar se posedonte 600 skeda vetëm për kuptimin e foljes أَهَدَ *âhadhâ* me gjitha derivatet e saj. Sipas ‘Abdulaziz Bin Humejd, Fischeri për materialin e vjelur për foljen أَهَدَ *âhadhâ* kishte konsultuar 292 burime.

Fischer, në parathënien e fjalorit të tij, thotë se është një numër mjaft i madh i veprave tejet të vlefshme që janë trashëguar nga e kaluara. Ai përmend një deklaratë të Xhâlâlu 'd-Dîn âs-Sujutiut (1445-1505), e botuar në vepër në tij âl-Mâz'hîr, botim i Bulakut 1865 . V. 1. F.49, ku thotë se më duhen gjashtëdhjetë deve për t'i bartur të gjitha veprat e mia të arabistikës.¹⁹ Mirëpo Fischer mendon se kjo deklaratë e Sujutiut mbase edhe ishte ekzagjeruar. Ai këtë e mbështet pikërisht në një prononcim të vetë Sujutiuku, ku thotë se veprat e hartuara nga pararendësit nuk janë më shumë se një barrë e një deveje.

Karshi veprave në gjuhën arabe në fusha të ndryshme të cilat i kishte konsultuar, Fischer sjell titujt e njëzetë e dy fjalorëve, ashtu siç i kishte renditur Edward Lane në parathënien e fjalorit të tij *Arabisht-anglisht*, duke filluar me fjalorin e parë të gjuhës arabe *Kitābu-l-ʿajni* të autorit Hâlîl Bin Ahmâd Bin Amr Bin Tāmîm (vdiq më 717-786) e deri te fjalori âl-Mutâhâşîş, me autor Ibn Sîdâh, i cili konsiderohet ndër fjalorët më shterues në historinë e leksikografisë arabe.

Në parathënie të fjalorit të tij, Fischeri thotë se ka mjaft shprehje që hasen në fjalorët e hartuar nga autorët arabë e që ai nuk ia ka dalë t'i hasë

¹⁹ أ. فيشر، المرجع السابق، ص ٣.

në asnjë vepër që kishte hulumtuar. Kjo, sipas Fischerit, lë mundësinë të konstatojmë se autorët e fjalorëve para tij kanë disponuar materiale gjuhësore të vjelura nga veprat të cilat nuk ia kanë dalë t'i mbejtojnë kohës, e të cilat sot nuk kemi mundësi t'i konsultojmë. Fischeri, deri diku, shpreh një dozë dyshimi në sakëtsinë e kuptimit të këtyrte fjalëve. Ai këtë e argumenton edhe me faktin se autorët arabë, në të shumtën e rasteve, kishin vjelur material nga divanet (përmbledhjet) e poezisë klasike dhe veprat letrare të gjeneratave të mëpasme, kryesisht të botuara në Egjipt dhe në Hajdarabad,²⁰ e që sipas tij duhet patur kujdes se ky leksik nuk prezantonte mbarë leksikun e gjuhës arabe.

Fischeri, duke qenë njohës i shkëlqyer i gjuhëve semite dhe josemite me të cilat ka qenë arabishtja në kontakt të vazhdueshëm, vëren se një korpus jo i paktë në fjalorët paraprakë janë konsideruar fjalë me prejardhje arabe. Ai sjell disa fjalë të cilat në fjalorët paraprakë janë konsideruar si fjalë arabe me rrënjë trekonsonante, e që në fakt janë huazime. Fischeri më tej thotë se autorët e deritanishëm në fjalorët e tyre kanë përfshirë vetëm leksikun e gjuhës letrare, kurse tani duhet menduar për hartimin e një fjalori bashkëkohor historik të arabishtes. Në këtë fjalor historik, thotë ai, duhet të përfshihet i gjithë leksiku i arabishtes, duke prezantuar zhvillimin e çdo fjale përgjatë periudhave historike nëpër fjalorët paraprakë.

Fjalori i Fischerit konsiderohet ndër fjalorët më të mirë të hartuar nga ana e orientalistëve që kanë kontribuar në leksikografinë arabe.²¹

²⁰ أ. فيشر، المرجع السابق، ص ٢٦.

²¹ عبد العزيز بن حميد بن محمد الحميد، المعجم التاريخي لدى المستشرق الألماني أوجست فيشر، شبكة صوت العربية.

<http://www.voiceofarabic.net/ar/articles/2355>

Fischeri që në fillim thotë se leksikun e fjalorit të tij e kishte vjelur edhe nga fjalorët e kolegëve të tij orientalistë. Ai ndër fjalorët më të mirë të hartuar nga perëndimorët përmend fjalorin *Supplement* të Reinhart Dozysë,²² fjalorin *Latinisht- arabisht* të Goliusit,²³ fjalorin tjetër *Arabisht- latinisht* të orientalistit gjerman Freytag.²⁴

Mirëpo hartuesit e Fjalorit historik të arabishtes të Dohas janë të mendimit se Fjalori i Fischerit nuk i plotëson të gjitha kushtet për t'u quajtur *fjalor historik*. Ata ndër arësyet kryesore cekin se Fischeri u mjaftua vetëm me materialin e vjelur në literaturën letërore dhe se u kufizua në zona të caktuara.²⁵ Sipas tyre, fjalori historik duhet të përfshijë leksikun nga të gjitha fushat, si nga fusha e letërsisë, shkencës dhe artit dhe se leksiku të vilet gjithandej ku është shtrirë gjuha arabe. Sipas tyre, arsyet kryesore se pse ky fjalor nuk mund të quhet fjalor historik, është se Fischeri është ndalur në fund të shekullit të tretë hixhri. Ata janë të mendimit se fjalori historik duhet të përfshijë leksikun më të vjetër të regjistruar të një gjuhe dhe të prezantojë zhvillimin e atij leksiku deri në periudhën e botimit të fjalorit, kurse fjalori i Fischerit përfshin vetëm leksikun e një periudhe të caktuar.²⁶

Një orientalist tjetër që i ishte rrekur hartimit të një fjalori të

²² Për më shumë për Reinhart Dozysë dhe fjalorin e tij, shih: Abdurrahman Bâdâvî, op.cit. f.316-321.

²³ Për më shumë, shih: Abdurrahman Bâdâvî, op. cit. f. 219 -222.

²⁴ Për më shumë, shih: Abdurrahman Bâdâvî, op. cit. f. 329.

²⁵ Rreth përkufizimit gjeografik të përdorimit të një shprehjeje të caktuar, Fischeri në parathënien e tij mangësi kryesore të fjalorëve paraprakë sheh se shumica e autorëve para tij janë bazuar vetëm në tekstet që janë vjelur në Egjipt. Ai mëton të ketë përfshirë edhe autorë të Gadishullit arabik. August Fischer, op. cit. f.26.

²⁶<https://www.google.com/search?q=%29%2F%23%2Fhttps%3A%2F%2Fëëë.dohadicti%28>.

arabishtes mjaft voluminoz është edhe Edward Lane. Fjalori i Edward Lanes titullohet *Arabice – English Lexicon (Meddu-l-kāmūs)*. Fjalori i Lanes, siç shihet edhe nga vetë fjala e botuesit, përfshinë gjitha foljet dhe derivatat e tyre dhe mënyrat e përdorimit të tyre. Fjalori i Lanes është përfshirë në tetë vëllime. Për hartimin e këtij fjalori, autorit i janë dashur tridhjetë e pesë vite punë.²⁷

Orientalisti Dr. G. P. Badger thotë se Fjalori i Lanes është një vepër e mrekullueshme, gjithëpërfshirëse, është i saktë dhe me një rënditje të thjeshtë të fjalëve. Ai më tej shton se ky fjalorë është ndër fjalorët më të mirë në cilën do gjuhë të botës.²⁸

Vëllimi i parë i fjalorit të E.Lanes është botuar në vitin 1863, kurse vëllimi i fundit, derisa ai ishte gjallë, është botuar në vitin 1876. Vëllimi i fundit, i teti me radhë, është botuar nën përkujdesin e nipit të tij Stanley Lane Poole, në vitin 1893.

E. Lane gjatë hartimit të fjalorit të tij, mbështetje kryesore ka pasur fjalorin *Lisānu-l-’arab*, por pa lënë anash edhe fjalorët *Tāxhul-l-’arūs* dhe *Kāmūsul-muḥīṭ*.²⁹

Pas projektit të Fischerit, kemi iniciativën e Abdulla âl-’Alājli (1914-1996) në Liban. âl-’Alājli ishte një studies i pasionuar i gjuhës arabe deri në atë masë sa që është quajtur edhe *Yll i gjuhës arabe*. âl-’Alājli konsiderohet një ndër studiuesit më të spikatur të reformimit të arabistikës.³⁰ Ai ia kishte dalë të vjelë një leksik të arabishtes, deri atëherë i pashembullt. Ishte tejet i

²⁷ Abdurrahman Bâdâvî, op. cit. f. 86.

²⁸ Për më shumë shih: Abdurrahman Bâdâvî, op. cit. f. 83-87.

²⁹ Për më shumë shih: Abdurrahman Bâdâvî, op. cit. f. 83-87.

³⁰ الدكتور أيوب أبو دية، موسوعة أعلام الفكر العربي الحديث والمعاصر، طبعة ثالثة، ٢٠١٨، المملكة الأردنية الهاشمية، ص٤٠٧-٤١٢.

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore bindur se kishte arritur në atë fazë që të hartojë një fjalor të veçantë në krahasim me pararendësit. Botoi katër pjesët e para në vëllimin e parë, të cilin e kishte titulluar: *âl-Mârxhi‘, mu xhâm vâsīt, ‘ilmij, lâgâvij, fânij, bi-hâsâbi lâfđhi*. Vëllimi i parë është botuar në vitin 1963, para luftës qytetare në Liban. Lufta qytetare në Liban rrezikoi vazhdimin e botimit të këtij fjalori. Gjatë kësaj lufte qytetare, një dorë e shëmtuar shkatërroi me mijëra skeda. Ishte planifikuar që i tërë ky fjalor të botohej në njëzetë e katër vëllime. Secili vëllim përbëhej nga njëzetë e katër pjesë. Megjithëqë ishin të përgatitur 576 kapituj, u botuan vetëm katër prej tyre. *âl-‘Alājī* kishte përgatitur një fjalor enciklopedik gjithëpërfshirës, me shpresë të hapte rrugë për një etapë të re në hartimin e një fjalori të përmamasave enciklopedike.³¹

Adulla *âl-‘Alājī* fjalorin e tij e kishte ndarë nëpër epoka. Epokën nga viti 742 deri në vitin 1515 e kishte ndarë në gjashtë periudha: Periudha e ndikimit të persianëve, turqve, bevahive, selxhukëve, mongolëve dhe memalikëve.

Pas këtij projekti të dështuar kemi një projekt tjetër të ashtuquajtur *âl-mu xhâm at-tarīhij âl-‘arabij* (MTA). Ky projekt ishte projekt i Fakultetit të Letërsisë, Qendrës për studime ekonomike dhe sociale dhe Shoqatës së leksikologëve arabë të Tunisit. Këto insitucione takimin e parë e mbajtën në vitin 1989, duke marrë vendimin se fillimi për hartimin e një fjalori historik të arabishtes ishte domosdoshmëri e kohës dhe se një fjalor historik i arabishtes do të prezantonte kujtesën gjuhësore dhe kulturore dhe civilizuese të popullit arab. Ekipi realizues i këtij fjalori udhëhiqej nga Dr. Râshād al-Ḥamzāvī. Ekipi ia kishte dalë të grumbullonte dëshmi nga krijimtaria poetike e nëntëdhjetë poetëve të periudhës paraislame, duke

³¹ سليمان بن صالح الخراشي، نظرة شرعية في فكر: عبدالله العلايلي، نظرات شرعية، (المجموعة السابعة)، ص ١١.

përfshirë periudhën nga viti 200 deri në vitin 600. Ata kishin hartuar 58.023 skeda. Projekti dështoi për shkaqe financiare dhe nuk e pa dritën e botimit.³²

Këto nismat të vazhdueshme për të pasur një fjalor historik të arabishtes u kurorëzuan më në fund më 2012, kur Qendra arabe për hulumtime dhe studime të avancuara me seli në Doha u zotua për ta përgatitur Fjalorin historik të gjuhës arabe. Përfundimi me sukses i fazës së parë të *Fjalorit historik të arabishtes i Dohas* (tani e tutje FHAD) u bë publik më datën 10.12.2018. Me këtë rast u mbajt konferenca shkencore me titullin *Fjalorët historikë të gjuhëve, krahasimet dhe qasjet*. Në këtë konferencë u prezantuan kumtesa rreth fjalorëve historikë të gjuhëve botërore, si Fjalori historik i gjuhës angleze, gjermane dhe frënge.

Dr. 'Azmi Bâsharâ, drejtor i Institutit të Dohas për studime të avancuara, në fjalën e tij me rastin e promovimit të këtij projekti, ndër të tjera theksoi se "ideja për hartimin e këtij fjalori nuk është e jona, por ne realizuam një projekt që ka qenë ëndërr e kahmotshme e mbarë opinionit akademik për të pasur një fjalor historik të gjuhës arabe."³³ Ky projekt, sipas tij, është realizuar falë punës kolektive të ekipit. Të gjithë ne kemi qenë të vetëdijshëm se na pret një rrugëtim i gjatë dhe me plot vështirësi, por në të njëjtën kohë kemi qenë të vendosur dhe këmbëngulës dhe, falë përkrahjes institucionale nga udhëheqësia e shtetit të Katarit, ia kemi dalë të realizojmë këtë projekt. Ai, më tej, me këtë rast shtoi se për një periudhë pesëvjeçare, duke u kordinuar të gjithë sektorët e ekipit, ia kemi dalë që të

³² <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>

معجم الدوحة التاريخي للغة العربية-الهدية الثمينة – للأمة. ³³ <https://www.alaraby.co.uk/opinion/2018/12/13/>

—— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore kemi Fjalorin historik të gjuhës arabe, një e arritur në nivel jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar.

Sipas Dr. ‘Azmiut, etapa e parë e hulumtimit të materies përfshin periudhën 700 vjeçare të historikut të gjuhës arabe. Kjo etapë fillon me shkrimet e para të gdhendura në gurë e deri në fund të shekullit të dytë hixhri. Faza e parë për realizimin e këtij projekti filloi në muajin maj të vitit 2013, kur u bë publike fillimi i fazës së parë e deri në bërjen publike të përfundimit të fazës së parë, në dhjetor të vitit 2018. Në këtë platformë janë regjistruar 100 000 fjalë.

Etapa e dytë do të përfshijë periudhën nga vitit 817 e deri në vitin 1117, kurse etapa e tretë përfshin periudhën deri në ditët tona.

Në vitin 2012 u ftuan ekspertë nga fusha e gjuhësisë si Râmzi Ba’lâbâk, Muhammâd âl-‘Abîdî, Izu ‘d-Dîn âl-Bushâjhî etj. Në krye të ekuipit u zgjodh Râmzi Ba’lâbâk, i cili me sukses ia doli të realizojë projektin për hartimin e FHAD.

Në këto takime u kërkua që të krijohet një ekip nga studiuesit e fushave përkatëse. U punua pa ndërprerë në atë drejtim dhe kur ekipi u kompletua, më 25.5.2013, u bë publike përbërja e tij. Ishte një ekip tejet serioz dhe profesional. Në këtë fazë u ngazhuan 300 leksikologë, studiues, ekspertë të informatikës dhe administratorë të projektit.

Synimi i kësaj nismie ka qenë finalizimi i FHAD, duke regjistruar korpusin gjuhësor gjithëpërfshirës të gjuhës arabe.³⁴

Ekipi realizues i FHAD kishte hartuar planin e realizimit në këto faza:

1. Faza e grumbullimit dhe klasifikimit të materialit.

³⁴ <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>.

Burimet e fazës së parë janë të kufizuara deri në fund të shekullit të dytë hixhri, duke përfshirë 772 tituj në fusha të ndryshme, si:

a. Leksiku i teksteve fetare, i cili përfshin 144 tituj në tri fusha:

1. Fusha e shencave të Kuranit, duke përfshirë 55 tituj;
2. Fusha e hadithit, e cila përfshin 48 tituj;
3. Fusha e shkencës së Fikhut dhe Akaidit, me 41 tituj.

b. Leksiku i teksteve letrare, i cili përfshin 500 tituj në katër fusha:

1. Divane të zgjedhur nga poezia klasike (paraislame), me 153 tituj;
2. Divane të zgjedhur nga poezia paraislame dhe islame, e periudhës emevite, fazës së parë të periudhës abasite e deri në fund të shekullit të dytë hixhri. Kjo fushë përfshin 252 tituj.
3. Divane të grupeve të autorëve dhe poezi të përzgjedhura, me 65 tituj;
4. Tekste të prozës artistike, 30 tituj.

c. Leksiku i teksteve historike, tekste të marsheve dhe të shkencave të tjera, i përfshirë në 82 tituj në dy fusha:

- Tekste të vjetra të gdhendura, 70 tituj;
- Tekste në papiruse të periudhës islame, 12 tituj.

2. Faza e redaktimit të materialit.

Pas grumbullimit të materialit, ekipi i ekspertëve të fushave ka bërë eliminimin e fjalëve të përsëritura. Është konsideruar i pranueshëm vetëm ai version i një fjale të caktuar që ka qenë e vjelur nga dokumentet më të besueshme. Gjithashtu janë eliminuar zërat e vjelur nga tekstet që nuk kanë qenë të periudhës gjegjëse. Ekspertët e hartimit të këtij fjalori historik kanë qenë tejet rigorozë karshi titujve të dyshimt dhe, në fund, zërat janë rënditur sipas vjetërsisë.

Mbishkrimet arabe të gdhendura

Ekipi realizues i FHAD, me qëllim të krijimit të një kodi gjuhësor gjithëpërfshirës, nuk ka lënë anash as edhe një tekst bazik. Ata kanë konsideruar se mbishkrimet janë shtylla kryesore e fjalorit historik në të cilin duhet mbështetur. Mbishkrimet gjithashtu janë konsideruar burimi kryesor që ushqen leksikun e gjuhës arabe duke ofruar informacione të mjaftueshme për historikun e një fjale të caktuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre mbishkrimeve të gdhendura, sipas autorëve të FHAD, nuk janë përfshirë në fjalorët paraprakë të gjuhës arabe. Mbishkrimet e përfshira në këtë fjalor historik janë të dy kategorive kryesore: mbishkrimet veriore të lashta arabe dhe mbishkrimet e vjetra arabe.³⁵

FHAD, sipas relizuesve të këtij projekti, mëton të jetë unikat, nuk do t'i ngjajë asnjë fjalori të arabishtes i hartuar deri sot. E veçantë e këtij fjalori është se ofron informata se kur për herë të parë është përdorur një fjalë e caktuar, si dhe paraqet raportin e saj me gjuhët e tjera të së njëjtës familje. Ajo që e bënë të veçantë këtë fjalor janë edhe informatat e huazimeve, duke ofruar të dhëna rreth origjinës së huazimeve qofshin ato huazime perse apo greke. Ky fjalor shpjegon edhe termet e fushave të ndryshme. Karakteristikë e veçantë e këtij fjalori është se për çdo fjalë ofron të dhëna se çfarë kategorie gramatikore i takon ajo fjalë, duke saktësuar se është emër, emër i prejardhur qoftë ai masdar, apo ndonjë formë tjetër e emrave të prejardhur, mbiemër, folje, qofshin ato folje kalimtare apo jokolimtare etj.

Duke marrë parasysh leksikun e trashëguar përgjatë këtyre shekujve, materiali i prezantuar në këtë fjalor do të ndihmojë edhe në ndriçimin e

³⁵ <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>

shumë enigmave edhe te gjuhët e tjera të gjalla që në një mënyrë apo tjetër kanë qenë në kontakt me gjuhën arabe.

Janë konsultuar 1.256 dokumente, poezi, përmbledhje poezishë, antologji të poezisë arabe të njohura, si *Kutub-l-ḥamāsa*, divane, tregime, etj.³⁶

Nga burimet e prozës janë konsultuar mëse 567 dokumente. Këtu janë përfshirë të gjitha burimet, mbështetur në dokumete nga veprat e ndryshme të prozës arabe.

Burim i pakapërcyeshëm në këto raste është leksiku i Kuranit dhe nëntë koleksionet e njohura të Hadithit.

Dhe në fund, janë përfshirë 89 burime ku janë përfshirë vepra të shkruara deri në shekullin e dytë hixhri (shek.VIII). Këto vepra iu përkasin fushave të ndryshme, si asaj të prozës letrare, Hadithit, Tefsirit, vepra të filologëve, letrarëve etj.

Hartimi i FHAD është një projekt unik në historinë e leksikologjisë arabe. Idetë e zhvillimit gjuhësor tek arabët kanë kaluar nëpër shumë pengesa, sidomos në Egjipt dhe në Siri. Koncepti i elokuencës ishte një nga pengesat e atij zhvillimi, sepse konsiderohej se duhet t'i rezistohej çdo ndryshimi në gjuhë. Megjithatë, FHAD na mundëson të njohim kulturën arabe dhe cilësinë e përceptimit të botës që e rrethon atë. Ky fjalor na mundëson të dimë se si janë përdorur fjalë të caktura për të shprehur mendimet, emocionet dhe nevojat e tyre brenda një kohe të caktuar. Gjithashtu, na ofron infomata të rëndësishme për qytetërimin arab, siç janë ushqimi, pijet, verërat, veshjet, armët dhe arkitektura. Nëpërmjet këtij fjalori

³⁶ <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>

—— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore historik njihemi me evolucionin e kuptimit të fjalëve përgjatë shekujve.

Gjatë hartimit të FHAD, karshi trashëgimisë, janë konsultuar edhe fjalorë modernë të termave nga shkencat e mjekësisë, astronomisë, fizikës, gjeografisë, matematikës, filozofisë dhe shkencave të tjera.

Në leksikografinë arabe, siç u cek edhe më lart, tradita e renditjes së fjalëve në fjalor, pavarësisht renditjes së konsonanteve, ka qenë një renditje e larmishme, varësisht nga ajo se cila shkollë e leksikografisë arabe është aplikuar apo nga ajo që ka qenë unike te të gjitha shkollat e leksikografisë arabe, që fjalët janë renditur sipas konsonantit të parë të rrënjës së fjalës.

Mirëpo, hartuesit e FHAD nuk kanë ndjekur asnjërin nga këto tradita, duke cekur arsyet e tyre. Ata janë përcaktuar të ndjekin një metodë tjetër. Bazuar në të dhënat që ofrohen në parathënie të FHAD dhe në platformën elektronike të FHAD, shihet se ata kanë ndjekur një sistem tjetër. Renditja e fjalëve në fjalor është bërë duke u bazuar në historinë e paraqitjes së fjalës në mbishkrime, në tekste apo kudo që është paraqitur një fjalë e caktuar. Ata janë të mendimit se ka qenë e pamundur që gjatë hartimit të këtij fjalori të ndjekin metodat e lartpërmendura. Sipas tyre, hulumtuesi vetëm në këtë mënyrë do të marrë informata për një fjalë se kur dhe ku është përdorur për herë të parë. Gjithashtu, ndodh që një fjalë të jetë përdorur në disa burime, dhe nuk do të dihej se në cilin burim është përdorur për herë të parë. Andaj ekipi i hartimit të FHAD, pas shumë konsultimeve, për shkak të natyrës së veçantë të këtij fjalori, u përqendrua që të ndjekë renditjen e fjalëve sipas një metodologjie të veçantë, deri tani e paparë në historinë e leksikografisë arabe. Për çdo fjalë është dhënë pasqyra kohore se kur është përdorur për herë të parë, cili është burimi dhe cili ka qenë kuptimi i saj në atë burim, duke vazhduar me kuptimet e tjera nëpër burime të tjera, aty ku është përdorur ajo

fjalë përgjatë historisë, që nga përdorimi i parë e deri në fund të shekullit të dytë hixhri.

Kjo renditje e bën të veçantë këtë fjalor dhe i jep kuptim emërimit të FHAD *Fjalor historik i gjuhës arabe*.

Kuptimi i një fjale të caktuar është ngusht i lidhur me historikun e përdorimit të saj që nga shfaqja në tekste të dokumentuara përgjatë historisë.


Qasja në platformën e FHAD është mjaft praktike dhe e lehtë. E gjitha që duhet bërë është që fillimisht duhet regjistruar në platformën e FHAD-it, e pastaj në dritaren ku janë të prezantuara të gjitha rrënjët kërkohet të shënohen bashkëtingëlloret rrënjësore të fjalës, kurse në dritaren tjetër të shkruhet fjala në formë të plotë. Posa të përfundohet me këto të dhëna, duhet të klikohet në ikonën *baḥṭḥkërkim*] dhe në ekran do të paraqitet e gjithë pasqyra e fjalës.

Me këtë rast, për të dëshmuar gjithë atë që u tha deri tani rreth informatave për një fjalë të caktuar, po sjellim një ilustrim rreth kuptimit dhe historikut të fjalës *kitāb* në FHAD:

- Në vitin 380, në poezinë e poetit Lākīṭ Jā'mur Bin Ḥārixhātu al-'Ijādī, me kuptimin *letër e shkruar*;
- Në vitin 594, në poezinë e poetes Dāḥtūs Bint Lākīṭ, me kuptimin *vdekje*;
- Në vitin 573, në poezinë e poetes al-Ḥirnik Bint Bâdr al-Bâqrijetu, me kuptimin *paracaktim*;
- Në vitin 617, në Kuran (69:19), me kuptimin *regjistër*;
- Në vitin 619 në poezinë e poetit 'Âbū ṭālib, me kuptimin *libër i shenjtë*;

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore

- Në vitin 625, në Kuran (98:3), me kuptimin *dispozitë*.³⁷




Platforma elektronike e FHAD është mjaft e pasur me të dhëna për historinë e gjuhës së shkruar arabe nëpër periudha të caktuara. Grafikonet në vijim na japin një pasqyrë mjaft të qartë për historikun e gjuhës arabe të shkruar.

Grafikoni nr. 1 ofron të dhëna për numrin e burimeve të gjuhës arabe të shkruar përgjatë periudhës kohore, duke filluar nga burimet e para e deri në vitin 200 hixhri,³⁸ kurse grafikoni nr. 2 na ofron një pasqyrë të qartë për avancimin e gjuhës arabe të shkruar përgjatë të njëjtës periudhë historike. Sipas grafikoni nr.2, shihet qartë se trajektorja e historisë së shkrimit të gjuhës arabe përgjatë periudhave të caktuara ka pësuar rënie. Sipas këtij grafikoni, shihet se përgjatë periudhës së shtetit Emevit kemi një rënie rapide, kurse me ardhjen e abasitëve në pushtet, grafikoni ka ngritje të dukshme.

³⁷ <https://www.dohadictionary.org/#/dictionary/%D9%83%D8%AA%D8%A7%D8%A8>

³⁸ <https://www.dohadictionary.org/#/charts>



Fjalori FHAD ofron të dhëna edhe për huazimet nga gjuhët përreth saj apo, siç janë quajtur, shprehje të rrënjësura në gjuhën arabe. Nëpërmjet këtij projekti, ekspertët kanë ofruar të dhëna rreth zhvillimit të gjuhës arabe përgjatë gjithë kësaj periudhe.

FHAD pa dyshim do të kristalizojë identitetin arab të banorëve të këtyre vendeve, duke e konsideruar si identitet universal dhe të jashtëzakonshëm karshi identitetit stërgjyshor dhe ideologjik, siç janë identitetet sektare, etnike, fisnore dhe rajonale.

Autorët e realizimit të FHAD pretendojnë se ky fjalor mundëson një rilindje gjithëpërfshirëse gjuhësore edhe në leksikografi, dhe me këtë krijon kushte për të avancuar punën në hartimin e fjalorëve terminologjikë të shkencave të ndryshme. Ky fjalor mundëson edhe rileximin e teksteve të vjetra nga kultura arabe.

Materialet në Fjalorin historik të arabishtes janë të botuara në platformë elektronike që ofron shërbime rreth leksikut, bibliografisë, kontekstualizimit, teksteve, burimet tekstuale dhe udhëzues për përdorimin e fjalorit.

FHAD, pavarësisht përpjekjeve të hartuesve për të qenë gjithëpërfshirës, ai megjithatë duhej të kufizohej për shkak të arsyeve objektive që vështirë tejkaloheshin. Përballë leksikut voluminoz të arabishtes, ishte vështirë të pretendohesh se edhe në këtë fjalor do të përfshihej e gjithë trashëgimia gjuhësore, marrë parasysh se një pjesë mjaft e madhe e teksteve ende janë në dorëshkrim dhe pa ndonjë studim kritik.

Edhe realizuesit e këtij fjalori historik të arabishtes nuk pretendojnë se kanë përfshirë gjithë leksikun e gjuhës arabe, ndërtimet, si dhe kuptimin e fjalëve që nga fillimi e deri në ditët tona. Duke marrë parasysh shtrirjen gjeografike të arabishtes, autorët e FHAD janë të vetëdijshëm se mund të ketë edhe tekste të periudhës deri në shekullin e dytë hixhri, e që këta nuk ia kanë dalë të arrijnë deri tek ato. Ka edhe mjaft mbishkrime të gdhendura që janë zhdukur e që kanë mbetur pa u përfshirë në këtë fjalor. Fjalori do të jetë i hapur për t'u plotësuar me fjalë të reja, apo fjalëve të regjistruara t'u shtohen kuptime që kanë pasur ato përgjatë historisë.

Për të prezantuar gjithë vlerat e FHAD, edhe sikur të shkruhej edhe një monografi e tërë, nuk është e mjaftueshme, por ne me këtë rast do të mjaftohemi me kaq, me shpresë që në të ardhme ky projekt aq i vlefshëm për arabistikën do të jetë në epiqendër të interesimit të arabistëve.

Publicistika arabe, me rastin e lansimit të kësaj platforme, FHAD e ka quajtur anije për të lundruar në detin e historisë së gjuhës arabe (âl-'Arabij âl-xhedîd, 13.12.2018). Kushdo që dëshiron të ketë informata për kuptimin e një fjale përgjatë një periudhe të caktuar, atë mund ta gjejë në FHAD.

Sipas përshtypjes së gjithë atyre të cilët kanë pasur rastin të njihen me këtë platformë në të cilën është përfshirë FHAD, del se tani ky fjalor historik i arabishtes së shkruar i ngjan pemës e cila rrënjët i ka në Doha, kurse degët gjithandej ku flietet arabishtja dhe gjithandej ku ka të interesuar për studimin e gjuhës arabe.

Le të shpresojmë që ky projekt madhor të përfundojë sipas planit të hartuar dhe, brenda kohës së paraparë, edhe arabishtja të ketë fjalorin e vet historik të plotë.

Doha's Historical Arabic Dictionary:

A twist of one-century efforts

Abstract *

The lexicography among the Arabs has a very early and sensational tradition. Despite the fact that the first Arabic dictionary had been compiled in the VIII century by Ḥalīl Bin Ahmad Bin al-Fārāhīdij, we had to wait for the XXI century to have the Historical Arabic Dictionary.

The initiative for compiling of the historical dictionary of the Arabic language was even earlier. One of the most serious initiatives for compiling a dictionary of this magnitude is that of the Arabic Language Academy in Cairo in 1932. Another initiative for the compilation of the historical dictionary of Arabic was that of the German Orientalist August Fischer in 1913. After this initiative we have the initiative of Abdulla 'ala-'Alājlī in Lebanon. Another project for the compilation of the historical dictionary of the Arabic language was also the project of the Association of the Arabic Language Academy and Sciences in Tunisia.

All these efforts were not fulfilled, and did not result in any concrete results for having the full Historical Arabic Dictionary. From Fischer's Dictionary, only the first volume was published in 1967 in Cairo and that of Abdulla al-'Alājlīt with only one volume published in 1963.

The project for the Historical Arabic Dictionary, the long-awaited project, was launched on May 25, 2013 by the Arabic Research Centre in Doha with a team led by Râmzi Ba'lâbak, and the completion of the first stage, out of three, was promoted in December 2018.

* Professor of Arabic Language at the Department of Oriental Studies, Faculty of Philology, University of Prishtina "Hasan Prishtina", author of the Arabic - Albanian Dictionary (2011).

